



29 shtator 2015, Prizren

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Komunat fqinje të Prizrenit duhet të rrisin transparencën financiare

Komunat fqinje të Prizrenit përballen ende me sfida sa i përket transparencës financiare në raport me publikun. Komunat e Rahovecit, Suharekës, Dragashit, Mamushës, Shtërpçës dhe Malishevës, duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për t'i ofruar publikut pasqyrat mbi realizimin dhe shpenzimin e mjeteve nga buxheti komunal.

Ekzekutivet e këtyre komunave kanë lejuar qasjen në dokumente publike për monitoruesit e EC Ma Ndryshe, përkatësisht kanë ofruar raportet financiare për periudhën janar-qershor 2015, ndonëse në këtë drejtim janë evidentuar edhe vonesa.

Komuna e Suharekës ka ofruar kopjen e raportit financiar gjashtëmuor, një muaj e gjysmë pas dorëzimit të kërkesës. Ndërsa komunave tjera i janë dashur mesatarisht rreth dy javë për të ofruar qasje në këtë dokument publik.

Megjithëkëtë ka komuna që këto raporte ende nuk i kanë publikuar në ueb faqet e tyre zyrtare. Në ueb faqet e komunave të Shtërpçës, Mamushës, Dragashit, Rahovecit e Suharekës nuk mund të gjenden raportet gjashtëmuore financiare, ndërkohë që ky dokument është postuar në ueb faqen e Komunës së Malishevës. Në ueb faqen e Komunës së Rahovecit figuron raporti tre muor financiar, derisa te komunat e Shtërpçës, Mamushës, Dragashit e Suharekës nuk mund të gjenden as këto informata.

EC Ma Ndryshe përkujton se transparenca financiare përbën një element kyç të menaxhimit efektiv të mjeteve publike, ku publikimi i të dhënave u mundëson qytetarëve kërkimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga lidhësi komunal. Raportet periodike financiare të qeverive lokale duhet të sigurojnë publikun se mjetet e takspaguesve shfrytëzohen në mënyrë të duhur dhe se i shërbejnë agjendës zhvillimore lokale. Informatat financiare duhet të jenë përmbajtësore e të plota, të besueshme dhe të qasshme për publikun. Prandaj publikimi i raporteve periodike financiare është një kriter minimal në përpjekjet për transparencë financiare.

Bazuar në këto të gjetura EC Ma Ndryshe thekson se transparenca financiare është jetike për vlerësimin e përgjithshëm të transparencës në një komunë. Të dhënat lidhur me buxhetin komunal sipas Udhëzimit Administrativ 05/2013 për Transparencë në Komuna janë dokumente publike.

Prandaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto EC Ma Ndryshe rekomandon komunat fqinje të Prizrenit që të rrisin transparencën buxhetore; të shtojnë përpjekjet që raportet financiare të publikohen online rregullisht dhe që përmbajtjet e tyre të jetë më të qarta për publikun, në mënyrë që të plotësohen së paku kriteret minimale për transparencë financiare.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i cili ka shtrirje në komunat e mëdha të Kosovës, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë, sikurse edhe në Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë dhe Shtërpçë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre. Indeksi i Transparencës paraqet edhe një përpjekje të strukturuar për të mbështetur komunat e Kosovës në përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë, të përcaktuara me reformën e qeverisjes lokale dhe agjendën evropiane të Kosovës.

Me respekt,  
Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*